



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada – Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog
Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencija za Razvoj Poloprivrede/Agriculture Development Agency

RAPORT I PUNËS SË AGJENCISË PËR ZHVILLIM TË BUJQËSISË PËR VITIN 2022

Shkurt 2023

HYRJE

Raporti Vjetor nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, është një prej dokumenteve më të rëndësishme për agjencinë. AZHB e sheh të rëndësishme nevojën për të informuar lexuesit e interesuar lidhur me reformat, iniciativat, aktivitetet dhe rezultatet e arritura gjatë vitit 2023, ju do të informoheni rreth të gjitha të dhënave relevante që janë gjeneruar ose grumbulluar nga drejtoritë përkatëse në AZHB, pa dyshim se duke parë potencialin që ka ky sektor, ende nuk kemi arritur aty ku ne e kemi synim. Ne do të rrisim në vazhdimësi përkrahjen, në veçanti duke u fokusuar në ato kulturat që sjellin vlera më të larta, por edhe në diversifikimin e aktiviteteve në ferma.

Treguesit e bilancit tregtar flasin për dominim të madh të prodhimeve të importit në tregun bujqësor të Kosovës. Posaçërisht problematikë për gjendjen e sektorit të bujqësisë përbën fakti i përballjes me një konkurrencë të ashpër nga importi, dhe pa ndihmën e duhur të shtetit dhe fondeve të BE-së, donatorëve të tjerë, vështirë se mund të ketë kushte të favorshme dhe konkurruese për fermerët në Kosovë. Megjithatë, bujqësia në Kosovë, vazhdon të jetë një nga degët më të rëndësishme dhe më premtuese për përmirësimin e treguesve makroekonomik. Roli i bujqësisë në zhvillimin ekonomik të vendit, konsiston në kushtet e favorshme që ka Kosova për zhvillimin e bujqësisë, përkatësisht disa sektorëve të saj. Kosova ka një popullsi relativisht të re, Bujqësia e Kosovës pra është sektor në konsolidim i cili do të ndikoj në përmirësimin e kualitetit të jetesës në vendbanimet rurale dhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Duke e ditur këtë fakt Qeveria e Republikës së Kosovës përkahtësisht MBPZHR ka treguar përkushtimin e saj për krijimin e parimeve të ekonomisë së qëndrueshme të tregut, dhe ka qenë e vendosur që përmes granteve për zhvillim rural dhe Pagesave Direkte të mbështet fermerët përmes skemave të qëndrueshme financiare. Gjithsesi, në vazhdim na presin shumë sfida të cilat i kemi paraqitur në këtë raport, që së bashku me ekspertët, investitorët dhe partnerët tanë përmes strategjive të ndryshme, do të mundohemi që të zbusim këto sfida dhe të arrimë rezultate pozitive. Raporti Vjetor është përgatitur duke bashkëpunuar ngushtë me drejtorit nga AZHB, MBPZHR, dhe agjenci të tjera. Ne do të vazhdojmë bashkëpunimin me të gjithë ata që dëshirojnë të kontribuojnë drejtë një zhvillimi të qëndrueshëm të bujqësisë dhe të bëjmë përpjekje që ky sektor të jetë më i suksesshmi në të ardhmën drejt zhvillimit ekonomik të Kosovës. Fokusi ynë kryesor është respektimi i legjislacionit dhe akteve nënligjore, vlërsimi i drejtë dhe i paanshëm, transparenca, ofrimi i shërbimeve më të mira për fermer, kompani dhe agrobiznese.

Me respekt

Venera Çerkini

Drejtoresha Ekzekutive në Agjencinë për Zhvillim të Bujqësisë

Ky raport paraqet aktivitetet e AZHB-së për periudhën kohore janar-dhjetor 2022 rreth të gjitha të dhënave relevante që janë gjeneruar ose grumbulluar nga drejtoritë përkatëse në AZHB

DEPARTAMENTI I AUTORIZIMIT TË PAGESAVE

Në raport janë paraqitur të dhëna për aktivitetet e zhvilluara për zbatimin e procedurave të parapara ligjore sipas legjislacionit në fuqi, e sidomos të kriterëve të parapara sipas Udhëzimit Administrativ për PZHR 2022 me nr. 04/2022 dhe plotësim ndryshimit të U/A 04/2022 me U/A 14/2022.

DAP edhe gjatë këtij viti ka hasur në vështërsi të natyrave të ndryshme, lidhur me zbatimin e procedurave të parapara (vonesa në Autorizim, mungesë e sistemit), për arsye të vitit pandemik (2020/2021), disfunkcionalizim i tërësishëm i sistemit për menaxhimin e granteve –moduli i Autorizimit të Pagesave, paqartësi dhe mangësi në U/A lidhur me afatet e zbatimit të projekteve dhe problem në furnizim dhe finalizim të projekteve nga ana e përfituesve, si pasoj e rritjes së çmimeve të imputeve të përdorura për zbatimin e projekteve, dhe vështërsi në furnizim sidomos me pajisje dhe mekanizim bujqësor, aktivitete të pa planifikuara të cilat janë kry si dhe probleme tjera.

Në DAP gjatë këtij viti kanë qenë të angazhuar nga 5 deri në 10 zyrtar, në periudha të ndryshme për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara. Një numër i konsideruar i tyre, gjegjësisht 50% e stafit të DAP ose janë transferuar në drejtori tjera ose kanë qenë në pushime të ndryshme, gjë që e ka vështirësuar zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara dhe atyre të pa planifikuara të cilat janë kry me kërkesë të stafit menaxherial edhe përkundër reagimeve tona.

Stafi i DAP është trajnuar dhe përgatitur për zbatimin e detyrave të përshkruara – autorizim të pagesave dhe nuk ka pasur ndonjë problem gjatë procesit.

Përveç në proces të Autorizimit, stafi profesional i DAP ka zhvilluar edhe aktivitete tjera të ndërlidhura me punët dhe detyrat e AZHB-së, si shqyrtimi i raporteve të EX POST kontrollave nga vitet 2017, 2018 dhe një pjesë të projekteve të vitit 2019, pjesëmarrje në komisione profesionale, mbështetje për drejtorit tjera të cilat kanë pas volum ma të madh të aktiviteteve, pjesëmarrje në trajnime, etj.

Para fillimit të procesit të autorizimit për programin e vitit 2022, janë organizuar dhe mbajtur sesione informative me fermer për shpalljen e programit të vitit 2022 për procedurat e miratimit dhe autorizimit të projekteve me qëllim të sqarimit të procedurave të autorizimit, dokumentacionin e nevojshëm, afatet e implementimit dhe qështje të tjera të identifikuara si pengesë për shmangien e gabimeve eventuale, e si pasoj edhe vonesa në autorizim dhe ekzekutim të pagesave. Duke u bazuar në vonesat në shpallje, miratim

të projekteve dhe pengesave të tjera teknike, DAP ka arritur që me sukses ta përmbyll vitin 2022 dhe të autorizoi të gjitha kërkesat për paradhënie për programin e vitit 2022, si dhe përmbylljen e të gjitha procedurave lidhur me të gjeturat e konstatuara gjatë EX POST kontrollit në vend ngjarje për programin e vitit 2017 dh 2018.

AKTIVITETET E REALIZUARA PËR AUTORIZIMIN E PAGESAVE

Gjatë vitit 2022 janë realizuar aktivitetet e planifikuara bazuar në planin e punës për vitin 2022, i hartuar pas miratimit dhe kontraktimit të projekteve nga drejtoria e miratimit. Hartimi i planit të autorizimit të pagesave është mvarë nga miratimi i projekteve dhe kontraktimi i tyre, andaj dhe planifikimi i Autorizimit ka qenë i diktuar nga ky proces. Duke pasur parasysh vonesat në hartimin e programit për mbështetje, nevojën për plotësim ndryshimin e U/A, dhe procedurat e miratimit të projekteve, ka pas vështërsi në hartimin e një plani të sakt lidhur me këtë.

Edhe përkundër vonesave dhe vështërsive të potencuara, DAP ka arritë që të shqyrtoj dhe autorizoj të gjitha kërkesat për paradhënie të cilat janë bërë për programin e vitit 2022.

Gjatë procesit DAP i AZHB-së ka zbatuar të gjitha kërkesat ligjore të dala nga Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, dhe U/A për zbatimin e Masave të përkrahura gjatë këtij viti.

Autorizimi i projekteve nga vitet paraprake të mbetura obligime të kontraktuara: si çdo vit edhe gjatë vitit 2022 janë autorizuar projektet e kontraktuara në vitet paraprake, të cilat kanë pasur shtyrje të afateve të implementimit apo (vendime nga komisionet e ankesave, vendime të gjykatave), apo ndonjë arsye tjetër. Nga obligimet e deklaruara nga vitet paraprake me gjithësejt 26 projekte me vlerë totale prej 2,231,431.90 euro, të bartura në vitin 2022, janë autorizuar dhe ekzekutuar të gjitha projektet të cilët kanë parashtruar kërkesë në afat, kanë plotësuar kriteret e parapara ligjore (sipas U/A të vitit përkatës), përkatësisht 17 projekte me vlerë totale prej **1,123,500.54 €**, kurse 9 janë refuzuar ose nuk kanë parashtruar kërkesë për pagesë, e për të cilat janë zhvilluar procedurat e parapara ligjore deri te kërkesa për procedura gjyqësore për kthimin e vlerës së paradhënies (avancit).

Autorizimi i projekteve nga programi 2022: Nga programi i vitit 2022, projektet të cilat për arsye të kohës së nënshkrimit të kontratave dhe hartimit të programit, janë miratuar dhe kontraktuar nga data 13.12.2022, ka vështirësuar në masë të madhe realizimin e aktiviteteve të planifikuara për autorizimin e kërkesave për paradhënie.

Kërkesat e para për paradhënie në DAP, kanë arritur me datë 16.12.2022. DAP menjëherë pas kërkesave të para është mobilizuar për autorizimin e këtyre kërkesave, duke pas kujdes në zbatimin e të gjitha

procedurave të parapara ligjore. Deri me datë 28.12.2022, janë autorizuar të gjitha kërkesat e arritura dhe të gjitha janë proceduar në DF të MBPZHR-së për ekzekutim.

Obligimet e kontraktuara: Edhe përkundër angazhimit maksimal të të gjithë stafit të drejtorisë së autorizimit për përmbylljen e procesit të autorizimit, gjatë periudhës raportuese kontraktimi i vonë i projekteve të miratuara ka pamundësuar fermerët për parashtrmin e kërkesave për paradhënie.

Bazuar në të dhënat nga sistemi i grant menaxhmentit, deri në hartimin e këtij raporti janë kontraktuar 278 projekte nga 3 masa (Masa 1, Masa 7 dhe Masa 5), kurse mbetet për tu kontraktuar Masa 3, si dhe dislokimi i mjeteve financiare nga njëra mas në tjetrën, që mund të rris numrin dhe vlerën e projekteve të kontraktuara e si pasojë edhe numrin dhe vlerën e obligimeve të kontraktuara.

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr.3, shihet se obligim kontraktual nga viti 2022 për vitin 2023 do të mbesin 278 projekte të kontraktuara me vlerë prej 8,951,450.49 € në total, duke përfshirë vlerat e kështit të dytë për projektet që kanë parashtruar kërkesa për paradhënie, dhe vlerën e përkrahjes publike për ata që nuk kanë parashtruar kërkesa për paradhënie.

Vlerës së programit të vitit 2022, duhet shtuar edhe vlerën e projekteve të pezulluara nga viti 2018 dhe 2019, të cilat janë në procedura gjyqësore që në total i bie se obligime të kontraktuara të bartura në vitin 2023 janë gjithsejtë 11,150,855.49 €.

AKTIVITETET TJERA TË ZHVILLUARA NË DRJTORINË E AUTORIZIMIT

Shqyrtimi i raporteve nga Eks Post kontrolli: Gjatë vitit 2022 janë shqyrtuar raportet nga EKS Post kontrolli i projekteve të viteve 2017, 2018 dhe një numri të projekteve nga viti 2019 për të cilët është kry monitorimi.

Pas shqyrtimit të raporteve të inspektoratit, ekipet e DAP të ngarkuara me shqyrtim të raporteve për projektet me të gjetura për të cilat është vlerësuar se mund të eliminojnë të gjeturat e konstatuara, ka adresuar shkresa me afat prej 30 ditësh për eliminim të gjeturave, duke ofruar dëshmi në formë të shkruar (parashtrim të kërkesës me dëshmi).

Për projektet e vitit 2017, të monitoruara me të gjetura kanë rezultuar 158 përfitues, të gjithë këtyre përfituesve ju kanë bërë shkresa për eliminim e të gjeturave me kërkesë të ofrimit të dëshmimeve, e në disa raste janë organizuar edhe ri eks post kontrolla për të verifikuar gjendjen në terren.

Pas përmbylljes së të gjitha procedurave administrative, edhe përkundër dhënies së mundësisë së eliminimit të të gjeturave një pjesë e fermerëve përfitues nuk ju ka përgjigjur kërkesës e si pasojë AZHB ka kërkuar kthimin e mjeteve të përfituara si mbështetje publike.

Ndaj të gjithë përfituesve që nuk ju kanë përgjigjur kërkesave të AZHB-së, për kthim të mjeteve është inicuar procedurë gjyqësore për kthim të mjeteve.

E njëjta procedurë është zbatuar edhe për fermerët përfitues të vitit 2018 dhe 2019, te të cilët janë gjetur shkelje të kontratës gjegjësisht mos mirëmbajtje e investimeve të realizuara përmes mbështetjes me grante investive.

Gjatë vitit 2022, janë inicuar 120 kërkesa për padi për kthim të mjeteve për përfituesit që kanë marrë paradhënie e nuk e kanë implementuar projektin, përfituesit që nuk kanë mirëmbajtur investimin gjatë periudhës 3 vjeçare të monitorimit apo janë refuzuar. Ky procesë do të vazhdoj edhe gjatë vitit 2023, marrë parasysh se një numër i përfituesve gjenden në proceset e parapara administrative.

Shqyrtimi i kërkesave për zgjatje të afatit të implementimit të projekteve të kontraktuara dhe kërkesave të tjera: Gjatë vitit në AZHB janë parashtruar ankesa të natyrave të ndryshme, pjesa ma e madhe e tyre në vendimet e autorizimit të pagesave, të cilat janë proceduar për shqyrtim në komisionet përkatëse për shqyrtim të ankesave apo në komisionin për rivendosje të afateve.

Gjithashtu gjatë vitit 2022, kemi patur kërkesa për shtyrje të afatit të implementimit të projekteve të përfituara si mbështetje publike, shumica e tyre janë miratuar dhe janë zgjatë afatet me aneks kontratë me plotësim ndryshimin e U/A 02/2020 me U/A 08/2021, i cili ka mundësuar që projektet e masës 101 dhe 302 të implementojnë projektet e tyre. Gjatë vitit janë shqyrtuar dhe miratuar mbi 20 kërkesa për shtyrje të afatit dhe janë nënshkruar Aneks Kontrata me fermer përfitues.

Ky vit karakterizohet me numër të madh të palëve në DAP, marrë parasysh numrin e madh të kërkesave pas procesit të monitorimit të projekteve nga vitet 2017, 2018 dhe 2019. Për sqarim lidhur me shkresat e adresuara për eliminimin e të gjeturave, si dhe kërkesa për sqarim të kërkesës për paradhënie. Ky aktivitet ka marrë shumë kohë dhe shpesh ka penguar zhvillimin normal të aktiviteteve ditore të stafit.

Trajnimi i stafit të DAP: Bazuar në nevojat për trajnim të stafit të DAP, krahasuar me përgjegjësit që dalin nga përshkrimi i detyrave të punës, volumit të madh të punëve, procedura të shumta për autorizim të një pagese, janë organizuar trajnime dhe konsulta me institucionet relevante si në aspektin procedural po ashtu edhe atë financiar.

Gjithashtu vlenë të potencohet ofrimi i këshillave dhe rekomandimeve të ekspertëve të KE dhe GIZ për organizimin e një serieje të puntorive për identifikimin e nevojave të AZHB-së për funksionalizimin e të gjitha drejtorive, me theks të posaçëm numri i stafit, logjistika, trajnimet, e deri te hapsira për punë efektive.

DREJTORIA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Ka bërë mirëmbajtjen e të gjithë regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë si:

Regjistri Elektronik i Fermerve (eFR);

Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS);

sLPIS-Mobile i cili përdoret për kontrollë në terren për sipërfaqe;

Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte i cili përfshinë këto module:

- ✓ Moduli për aplikimin në zyret komunale dhe
- ✓ Modulin për menaxhimin e Pagesave Direkte në AZHB.

Ueb aplikacioni për aplikim për grante;

Regjistri për Menaxhimin e Granteve i cili përfshin keto module:

- ✓ Modulin për kërkesën për pagesë të granteve;
- ✓ Modulin për menaxhimin e granteve;
- ✓ Modulin për autorizimin e pagesave të granteve;
- ✓ Moduli i kontrollit në terren për projekte të zhvillimit rural;

Web faqja e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Drejtorja e Teknologjisë Informative ka bërë mirëmbajtjen e të gjithë kompjuterive të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, duke përfshirë edhe 7 (shtatë) Zyret Regjionale. Gjatë vitit 2022, Drejtorja e Teknologjisë Informative ka bërë menaxhimin e të gjithë shfrytëzuesëve (usereve), të domenit shtetrorë të zyrtareve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, për krijimin e llogarive zyrtare dhe vazhdimin e tyre për qasjen në domenin shtetror. Të gjithë zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë janë të qasur në server (share folder), për ruajtjen direkte të të dhënave në server. Nga Drejtorja e Teknologjisë Informative bëhet ruajtja (backup) i të gjitha të dhënave që janë të ruajtura në server (share folder), ruajtja (backup) e të dhënave për Regjistrin për Menaxhimin e Granteve (në këtë softuer përfshihet menaxhimi i granteve, ueb aplikacioni për aplikimit për grante, moduli për plotësimin e kërkesës për pagesë në zyrët regjionale të AZHB-së, autorizimi i pagesave të granteve dhe moduli i kontrollit në terren), gjithashtu edhe ruajtja (backup) i të dhënave të serverit ku është instaluar Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR), ruajtja (backup) i të dhënave të Regjistrin për Menaxhimin e Pagesave Direkte si dhe ruajtja (backup) i të dhënave të Sistemit të Thjeshtësuar për Identifikimin e Parcelave të Tokës (sLPIS).

Drejtoria e Teknologjisë Informative gjatë vitit 2022, ka bërë përgaditjen e kampanjës për aplikim për vitin 2022 për Projekte të Zhvillimit Rural sipas masave dhe nënmasave të caktuara në Udhëzimin Administrativ për Projekte të Zhvillimit Rural, si dhe përgaditjen e regjistrit për vlerësimin, miratimin dhe kontraktimin e projekteve. Pas përgatitjes së regjistrit për aplikim është dhënë mbështetje gjatë gjithë kohës së regjistrimit të aplikacioneve. Për Pagesa Direkte gjatë vitit 2022, është bërë përgaditja për aplikim përmes Regjistrit për Menaxhimin e Pagesave Direkte, i cili përfshinë dy module: moduli për aplikim në zyret komunale dhe modulën për menaxhimin e Pagesave Direkte në AZHB, ku është bërë përgaditja për aplikim për të gjitha llojet e subvencioneve për vitin 2022, si dhe është bërë përgaditja e Sistemit të Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS), ku është bërë kopjimi i të gjitha parcelave të vitit 2021 në vitin 2022 (për të lehtësuar aplikimin e fermerëve). Pas përgatitjes së kampanjës për aplikim për vitin 2022, janë mbështetur direkt nga zyrtaret komunal gjatë regjistrimit të aplikacioneve gjatë gjithë kohës së kampanjës për aplikim. Po ashtu, gjatë vitit 2022 është përgaditur kampanja për aplikim për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë dhe therrjet e raportuara të gjedhit për gjashtëmujorin e parë TM1, dhe gjashtëmujorin e dytë TM2.

Gjatë vitit 2022, Drejtoria e Teknologjisë Informative ka bërë mirëmbajtjen dhe monitorimin e 2 blade enclosure, 7 blade server, 2 MSA storage, 2 External Ethernet Sëitches, 1 unitreds, 1 ultrium tape drive.

Gjatë vitit 2022 në Regjistrin e Granteve, përkatesisht në modulën për miratimin e granteve, është përdorur forma e dërgimit të sms-ve në mobil tek fermërt dhe dërgimi i vendimit në emailin e fermerit për tu njoftuar lidhur me vendimin e marë për aplikacionin e tij, gjithashtu e njejtë formë e dërgimit të sms-it dhe vendimit është përdorur edhe tek Regjistri i Pagesave Direkte.

Gjatë vitit 2022, Drejtoria e Teknologjisë Informative ka bërë administrimin e të gjithë regjistrave që shfrytëzon AZHB-ja. **Ueb faqja:** Mirëmbajtja e ueb faqës së Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), bëhet nga Drejtoria e Teknologjisë Informative. Gjatë vitit 2022 janë publikuar të gjitha thirrjet për aplikim për Grante dhe Subvencione, formularët për aplikim, listat e përfituesve të granteve dhe subvencioneve, udhëzuesit për aplikues, udhëzimet administrative si dhe materiale të ndryshme informuese të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Publikimi i këtyre informatave është bërë në gjuhën Shqipe dhe Serbe.

DEPARTAMENTI I PAGESAVE DIREKTE

Programi për Pagesa Direkte për vitin 2022, është implementuar nga Drejtoria e Pagesave Direkte me pak vonesë sa i përket afateve të parapara dhe planit të punës për vitin 2022, por kjo vonesë ka ndodhur për shkak të vonesave në hartimin dhe aprovimin e Programit të Pagesave Direkte 2022, si dhe Udhëzimit Administrativ 02/2022. **Periodha e aplikimit ka qenë nga data 26.04.2022 deri me 01.06.2022.**

Implementimi i Programit është bërë duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2022, dhe Programin e Pagesave Direkte 2022.

Raporti është përmbledhur në mënyrë specifike për secilin nënsektor duke paraqitur të dhëna për përfituesit, të refuzuarit, lëndët që janë ende në proces dhe nuk kanë përfunduar, sipërfaqet apo krerët e kafshëve të subvencionuara, subvencionet për akuakulturë dhe ato për cilësi të qumështit, buxheti i shpenzuar sipas secilit nënsektor dhe sipas komunave, si dhe buxheti total i shpenzuar për implementimin e komplet Programit për vitin 2022.

Vlenë të theksohet se këtë vit (2022), ka pasur një përkrahje më të madhe tek të gjithë nënsektorët, që kanë përfituar subvencionimin për sipërfaqet e tokës bujqësore të mbjellë/kultivuar, njëkohësisht kanë përfituar edhe subvencionimin e pjesëshëm të çmimit të naftës për litër, në vlerë prej 0.36 €/litër, për sasinë e naftës prej 150 l/ha, e cila është e nevojshme për kultivimin e 1 ha të tokës bujqësore, dhe ka qenë vlerë shtesë mbi subvencionimin bazë për të gjitha sipërfaqet e tokës bujqësore që janë pranuar për subvencionim.

Fermerët/aplikuesit, që kanë përfituar subvencione për sipërfaqet e tokës bujqësore të mbjellë/kultivuar me kulturat bujqësore: grurë, misër, patate dhe fasule si monokulturë, kanë përfituar edhe nga subvencionimi i pjesëshëm për sasinë e plehut artificial të shpenzuar/përdorur gjatë kultivimit, në vlerë prej 150 €/ha për grurë, ndërsa në vlerë prej 100 €/ha për misër, patate dhe fasule si monokulturë, dhe kjo ka qenë vlerë shtesë mbi subvencionimin bazë për të gjitha sipërfaqet e tokës bujqësore të mbjella/kultivuara, me kulturat bujqësore: grurë, misër, patate dhe fasule monokulturë, të cilat janë pranuar për subvencionim këtë vit.

DEPARTAMENTI I MIRATIMIT TË PROJEKTEVE

Gjatë vitit 2022, nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, gjegjësisht nga Drejtorati i Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural është bërë zbatimi i Programit të Zhvillimit Rural, duke përfshirë masat, nën-masat dhe sektorët e Zhvillimit Rural që janë pjesë e PZHR-së 2022.

Objektivat e përgjithshme të PZHR-së 2022

Rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë Kosovare dhe zëvendësimi i importit;

Krijimi i vendeve të reja të punës në bujqësi dhe zonat rurale;

Përkrahja e bujqëve në sektorët e përzgjedhur, me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikatat e BE-së;

Përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror duke synuar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zhvillimit të fermave;

Adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme.

Në vitin 2022 ka qenë i përgatitur Programi për Zhvillimin Rural si tërësi ku janë përfshi masat, sektorët dhe nën masat si ne vijim:

- 1. MASA 1 - “Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore”;**
- 2. MASA 3 – “Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore”;**
- 3. MASA 7 – “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve”;**
- 4. MASA 5 – “Zbatimi i Strategjive Zhvillimore Lokale qasja- LEADER”.**

Buxheti i paraparë për investime sipas masave dhe nën masa për PZHR-në 2022Ndarja e planifikuar buxhetore për Masën 1 “Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore” për vitin 2022Nga numri i aplikacioneve të cilat i kanë plotësuar kriteret e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes duke u bazuar në buxhetin e paraparë për PZHR-në, dhe rezultateve të përzgjedhjes për vitin përkatës 2022, janë miratuar/kontraktuar gjithsejtë deri më tani 477 projekte me një vlerë prej **23,538,283.15 €**.

DEPARTAMENTI PËR ZYRTAR REGJIONALE

DKZR është e angazhuar t'i kontribuoj AZHB-së në përmbushjen e Misionit dhe Vizionit të saj, për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësisë përmes implementimit të programeve mbështesë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

DKZR gjatë vitit 2022, përveç përmbushjes së detyrave të përcaktuara si Departament është angazhuar edhe në përkrahjen e Departamenteve tjera sipas nevojave dhe kërkesave të paraqitura në vazhden e aktiviteteve të ndryshme, kjo kryesisht është si rezultat i mungesës së theksuar të stafit në përgjithësi në AZHB.

DKZR për dallim nga viti 2021, që deri kah mesi i vitit ishte pa asnjë zyrtar, në vitin 2022 nga 1 shkurti janë transferuar 5 (pesë) zyrtar të pranimit të dokumenteve, përmes projektit të Bankës Botërore (BB), në zyrtarë publikë me akt emërimi të përhershme, sipas Ligjit për zyrtarët publik. Këta zyrtar janë sistemuar në 5 Zyrat Regjionale (ZR) për pranimin e dokumenteve/pakos për pagesë. Pas një periudhe njëri nga këta zyrtar, përkatësisht zyrtari në ZR Prizren ka ofruar dorëheqje dhe tani momentalisht e kemi të pa mbuluar me zyrtarët përkatës të pranimit të dokumenteve në ZR Prizren. Gjithashtu në ZR Gjilan nuk kemi zyrtar të pranimit të dokumenteve dhe aktualisht këtë detyrë e përmbush zyrtari i pranimit në ZR Ferizaj, ndërsa ZR

Prishtinë mbulohet përmes zyrtarit të pranimit të angazhuar me kontratë prokurimi për periudhë një vjeçare, që skadon në shkurt 2023. Gjithashtu kanë qenë të angazhuar tre zyrtare përmes marrëveshjes me Ministrinë e Financave dhe Transferim për periudhë gjashtë mujore.

Kërkesat për pagesë dhe kërkesat për avance, bazuar në Udhëzimin Administrativ (UA), dhe plotësim ndryshimet e UA, janë pranuar nga zyrtarët e pranimit në ZR të cilat kanë qenë të mbuluara me zyrtaret e pranimit, ndërsa për ZR Gjiilan e cila nuk ka zyrtar të pranimit, kërkesat janë pranuar nga zyrtari i pranimit në ZR Ferizaj, për ZR Prizren nga zyrtarja e pranimit në ZR Prishtinë dhe për ZR Pejë (ku zyrtarja e pranimit gjendet në pushim të lehonisë), kërkesat janë pranuar nga zyrtari i pranimit në ZR Gjakovë. Kjo zgjidhje për pranimin e kërkesave është bërë në pajtim me zv. Kryeshefin Ekzekutiv (KE), meqenëse DK ka refuzuar që të na ofroj përkrahje me zyrtarët e kontrollit në këto ZR.

Shumica e zyrtarëve të pranimit nëpër ZR nga qershori deri në fund të dhjetorit kanë qenë të angazhuar në Drejtorinë e Kontrollit për përkrahje në kontrollat në terren për implementimin e programit të Pagesave Direkte (PPD) të vitit 2022.

Vlenë të theksohet me këtë rast, se përkundër numrit të kufizuar të zyrtarëve në DKZR, të gjitha obligimet të cilat janë në kuadër të detyrave të Departamentit janë përmbushur në mënyrën më të mirë të mundshme. Përveç detyrave sipas pozitës që kanë zyrtarët e pranimit në kuadër të DKZR, nga muaji qershor përmes vendimit të zv. Kryeshefit, janë angazhuar në Drejtorinë e Kontrollit (DK), për të përkrahur në kontrollat në terren për Programin e Pagesave Direkte (PPD) të vitit 2022.

DEPARTAMENTI I KONTROLLIT NË TERREN

Pas analizës vjetore të punës dhe nxjerrjes së konkluzioneve lidhur me proceset e realizimit të punëve në vitin paraprak, janë ndërmarrë masat e duhura për eliminimin e dobësive dhe përmirësimin e fushave ku janë shfaqur këto dobësi, si në dokumentacion, në qasjen ndaj programeve dhe projekteve, kontrollin fizik në terren, etj.

Poashtu, janë hartuar Planet Sektoriale për secilin Sektor të Kontrollit, Pagesave Direkte dhe Projekteve të Zhvillimit Rural dhe është hartuar Plani Vjetor i Punës së Drejtorisë së Kontrollit, i cili përveç analizës së kontrollit nga viti paraprak i përfshirjes së resurseve në dispozicion, ka paraparë edhe kornizën kohore të përfundimit të kontrollit për Programet Mbështetëse të vitit 2022, që është realizuar në Kornizë të Përgjithshme sipas Planit të Paraparë, përveç shtojcës së kontrollit PZHR-2022, nga ana e DMPZHR, në vijim të 2023.

Pas përfundimit të këtyre shqyrtimeve dhe analizave administrative janë bërë përgaditjet teorike, duke hartuar Dokumentacionet për Procedurat Përkatëse të Kontrollit dhe agjendat për **trajnime praktike** në

terren. Trajnimet janë konceptuar kryesisht për Inspektorët e terrenit që janë fillestar si dhe në rifreskimin e njohurive dhe pëforcimin e tyre në fushat ku në vitet paraprake kemi qëndruar më dobët.

Gjatë vitit 2022, kemi organizuar trajnim dy ditor në Zyrat Regjionale në Pejë –Insituti Bujqësor, me të gjithë Inspektoratin e terrenit lidhur me zbatimin e kontrollit në terren për pagesa direkte i cili ka qenë shumë i efektshëm, trajnime tjera nuk kemi mundur të organizojmë për shkak të punëve të vazhdueshme dhe kontrollit të vazhdueshëm në terren.

Superkontrolli – Përveç fazës së Ex-Post Kontrollit, janë zhvilluar superkontrolle nga ana e stafit të lartë, Drejtorisë së Kontrollit për raste të veçanta të kontrollit, në raste kur kontrolli i rregullt nuk ka mundur të përmbushë ndonjë kontrollë, kur pala nuk është pajtuar me atë vlerësim dhe ka pasur objeksione ose vërejtje pakënaqësi në të gjetura, është bërë një mbikqyrje dhe Riverifikim dhe janë përmyllur Raporte të reja duke zgjidhur situatat. Superkontrolli Mbikqyrës për punën e Inspektorëve të Terrenit, si proces i cili ka për qëllim monitorimin, verifikimin dhe mbikqyrjen e punës së inspektorëve edhe këtë vit ka qenë i organizuar jo nga Drejtoria e jonë por nga Sekretari i Përgjithshëm i MBPZHR-së, dhe lidhur me këtë proces nuk kemi të dhëna nga Ekipi Përkatës.

Rikontrolli i cili është caktuar nga komisioni i shqyrtimit të Pagesave Direkte.

Raportimi- Për Eprorët, Kryeshefin dhe Kabinetin e Ministrin, është bërë për Pagesa Direkte në Bazë Ditore, kurse Raportimet tjera zhvillohen në bazë javore, mujore, tremujore, jetore, si dhe në raste e për raste të veçanta.

Angazhimi dhe pjesëmarrja në komisione të shumta dhe të shpeshta, janë punë shtesë e gjithë stafit Drejtues të Drejtorisë së Kontrollit, gjë që është bërë pa konsultime paraprake dhe në kundërshtim me Ligjin e Procedurave Administrative sepse nuk lejohet që një Zyrtar të jetë njëkohësisht në minimum tri komisione, poashtu emrimi në to ka qenë pa asnjë konsultë paraprake, duke na shkaktuar shpesh ngecje në kryerjen e punëve të përditshme dhe mungesë të zgjidhjes në kohë të punëve dhe problemeve të paraqitura.

Si Insitucion i cili kryen të gjitha kategoritë e Kontrollit në terren, që parashihen me Programe dhe U.A. dhe sipas kërkesave tjera, komisioneve të ankesave, kërkesave të aplikantëve etj, si:

- Kontrolli i Parë – PZHR – DMPZHR;
- Kontrolli i Dytë – PZHR – DAP;
- Kontrolli i Pagesave Direkte – DPD;
- Ex-Post Kontrolli;
- Rikontrollet dhe Plotësimet e Raporteve.

Drejtorja e Kontrollit duhet adaptuar, kriteret për secilën njësi kontrolli, raportet dhe dokumentet tjera, sipas njësive përkatëse dhe duhet përgjigjur në kohë optimale afateve të kontrollit, nuk është trajtuar dhe as mbështetur me seriozitetin e duhur dhe rolin e rëndësishëm që ka, duke pasur parasysh se është vija e kontaktit me fermerët aplikues dhe bartëse e lëvrimin të Fondeve Publike, as në resurse humane as në resurset tjera teknologjistike dhe të vendosjes në Zyrat Regjionale.

Duhet theksuar se mungesa e Definimit të qartë të statusit të Institucionit, mungesa e bazës së mjaftueshme juridiko-administrative të operimit, mungesa e buxhetit operativ të insitucionit, mungesa e mbështetjes operativo-logjistike, kushteve të punës, motivimit të të punësuarve, kanë sjellur një ulje të interesit të të punësuarve për të qenë të angazhuar dhe përkushtuar dhe të humbin motivin e angazhimit dhe kryerjes së detyrave të punës.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Vlenë të theksohet se nga viti 2023, buxheti është transferuar në kuadër të AZHB-së, ku presim që të kemi qasje në programin Free-Balance, BDMS dhe PIP (programe për planifikim dhe ekzekutim të buxhetit), i cili na mundëson që ti kryejmë pagesat në mënyrë të pavarur dhe direkte, andaj jemi në pritje dhe planifikojmë se në fillim të vitit 2023 këto pagesa do realizohen nga Drejtoria e Financave në kuadër të AZHB-së, pasi që është njëri ndër kriteret e KE-së për akreditim lidhur me menaxhimin e fondeve IPARD. Deri më tani këto pagesa bëhen në kuadër të MBPZHR-së.